
Nga mormonandgay.lds.org.

Perëndia i Do të Gjithë Fëmijët e Tij

Asgjë nuk e tregon më tërësisht thellësinë dhe shtrirjen e dashurisë së Perëndisë sesa gatishmëria e Tij për të sakrifikuar Birin e Vet që ne, fëmijët e Tij, të mund ta mposhtim vdekjen dhe të na ofrohet jeta e përjetshme. “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme” (Gjoni 3:16). Asgjë nuk e shpreh më mirë dashurinë e Jezu Krishtit sesa gatishmëria e Tij për të dhënë jetën e Vet që të shlyente mëkatet e njerëzimit, që të dëmshpërblente për të gjithë vuajtjen e padrejtësinë dhe që të thyente rripat e vdekjes për të gjithë (shih Alma 7:11–13). “Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij” (Gjoni 15:13).

Në një bisedë të konferencës së përgjithshme të tetorit 2009, Presidenti Diter F. Uhtdorf përshkroi dashurinë e Perëndisë:

“Perëndia nuk shikon pamjen e jashtme. Unë besoj se Ai nuk e ka për gjë nëse ne jetojmë në një kështjellë apo shtëpizë, nëse jemi të pashëm apo të rëndomtë, nëse jemi të famshëm apo të harruar. Edhe pse jemi të paplotë, Perëndia na do plotësisht. Edhe pse jemi të papërsosur, Ai na do përsosurisht. Edhe pse mund të ndihemi të humbur e pa busull, dashuria e Perëndisë na mbështjell tërësisht.

Ai na do sepse është i mbushur me një masë të pafundme dashurie të shenjtë, të pastër dhe të papërsosurshme. Ne jemi të rëndësishëm për Perëndinë jo për shkak të jetëshkrimit (C.V.) tonë por sepse jemi fëmijët e Tij. Ai e do secilin prej nesh” (“Dashuria e Perëndisë”, konferenca e përgjithshme e tetorit 2009).

Perëndia na do të gjithëve. Ai i do njerëzit e besimeve të ndryshme dhe ata pa asnjë lloj besimi. Ai i do ata që vuajnë. Ai i do njëlloj të pasurit dhe të varfrit. Ai i do njerëzit e çdo race dhe kulture, të martuarit ose beqarët, si dhe ata që përjetojnë tërheqje ndaj së njëjtës gjini ose që identifikohen si gej, lesbike apo biseksualë. Dhe Perëndia pret nga ne që ta ndjekim shembullin e Tij.

Ne Urdhërohemi ta Duam Perëndinë dhe Njëri-Tjetrin

“Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde. Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsì vetveten’” (Mateu 22:37–39).

“Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve” (Gjoni 15:12).

Ne e tregojmë dashurinë tonë për Perëndinë duke mbajtur urdhërimet e Tij (shih Gjoni 14:15) dhe duke e dashur njëri-tjetrin (shih Gjoni 13:34). Nëse keni një pjesëtar të familjes ose mik që përjeton tërheqje ndaj së njëjtës gjini ose identifikohet si gej, duajeni atë. Presidenti Henri B. Ajring vërejtí:

“Nëse doni të qëndroni afër me dikë që ka qenë i dashur për ju, por nga i cili jeni larguar, ju e dini se si ta bëni atë. Ju do të gjenit një mënyrë për t’i folur atij, do ta dëgjonit atë dhe do të zbulonit mënyra për të bërë gjëra për njëri-tjetrin. Sa më shpesh që të ndodhte ajo, sa më shumë që të zgjaste, aq më e thellë do të ishte lidhja e dashurisë. Nëse do të kalonte shumë kohë pa folur, pa dëgjuar dhe pa bërë gjë, lidhja do të dobësohej. Perëndia është i përkryer e i plotfuqishëm dhe unë e ju jemi të vdekshëm. Por Ai është Ati ynë, Ai na do dhe na ofron të njëjtën mundësi për t’u afruar më pranë Tij, ashtu siç do të bënte një mik i dashur. Dhe ju do ta bëni atë pothuaj në të njëjtën mënyrë: duke folur, duke dëgjuar dhe duke bërë” (“To Draw Closer to God”, konferenca e përgjithshme e prillit 1991).

Ju e tregoni dashurinë tuaj për Perëndinë duke i dashur dhe duke u shërbyer të tjerëve. “Dhe vini re, unë jua them këto gjëra që ju të mund të mësoni urtësi; që ju të mund të mësoni se kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj” (Mosia 2:17).

Çfarë do të thotë ta duam njëri-tjetrin? Dashuria tregon kujdes. Dashuria dëgjon. Dashuria përfshin. Dashuria frymëzon. Dashuria është në zemër të asaj që na bën njerëzorë, sepse ne jemi fëmijë të Perëndisë dhe “Perëndia është dashuri” (1 Gjon 4:8). Në Darkën e Fundit, Shpëtimtari përsëriti: “Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:35).

Urdhërimi për ta dashur njëri-tjetrin përfshin ata të cilët nuk e shohin botën në të njëjtën mënyrë siç e shohim ne. Siç shpjegoi Plaku Dallin H. Oaks:

“Në kaq shumë marrëdhënie dhe rrethana në jetë, ne duhet të jetojmë me ndryshimet. Atje ku është jetike, ana jonë e këtyre [dallimeve] nuk duhet të mohohet apo braktiset por, si pasues të Krishtit, ne duhet të jetojmë në paqe me të tjerët që nuk kanë të njëjtat vlera me ne apo që nuk i pranojnë mësimet mbi të cilat ato bazohen. Plani i Atit për shpëtimin, të cilin ne e njohim me anë të zbulimit profetike, na vendos në një rrethanë në vdekshmëri ku ne duhet t’i mbajmë urdhërimet e Tij. Kjo përfshin t’i duam fqinjët tanë me kultura dhe bindje të ndryshme, ashtu si Ai na ka dashur ne. Ashtu si dha mësim një profet i Librit të Mormonit, ne duhet të shkojmë përpara, duke pasur ‘dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit’ (2 Nefi 31:20)” (“Dashuria për të Tjerët dhe të Jetuarit me Ndryshimet”, konferenca e përgjithshme e tetorit 2014).

Dashuria hyjnore nuk e justifikon mëkatën – “Unë, Zoti, nuk mund ta shoh mëkatën as me shkallën më të vogël të lejimit” – por dëshiron që të falë – “megjithatë, ai që pendohet dhe i bën urdhërimet e Zotit, do të falet” (DeB 1:31–32). Në të njëjtën mënyrë, ne nuk duhet të bëjmë kompromis për mënyrën se si i jetojmë dhe i mbrojmë urdhërimet e Perëndisë por, që ta pasqyrojmë tërësisht dashurinë e Perëndisë, ne gjithashtu duhet ta duam njëri-tjetrin kaq sinqerisht dhe plotësisht saqë asnjë njeri të mos ndihet i braktisur ose i vetmuar apo i pashpresë.

Shpëtimtari Ka një Kuptueshmëri të Përsosur për të Gjitha Vështirësitë Tona

“Tani në fakt, ne shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe për faqe; tashti njoh pjesërisht, kurse atëherë do të njoh thellë ashtu sikurse njihem” (1 Korintasve 13:12).

Si njerëz të vdekshëm, kuptueshmëria jonë është e kufizuar. Mund të shpallim me Nefin që ne “e di[më] se ai i do fëmijët e tij; megjithatë, [ne] nuk e di[më] kuptimin e të gjitha gjërave” (1 Nefi 11:17).

Ndërsa kërkojmë përgjigje dhe drejtim për udhëtimin tonë vetjak, ne mund t’i mirëbesojmë Perëndisë dhe fuqisë së qenësishme në flijimin shlyes të Jezu Krishtit. Kur Jezu Krishti mori mbi Vete mëkatet e botës, Ai gjithashtu përjetoi çdo dhembje dhe vuajtje që mund të përjetojë çdo qenie njerëzore:

“Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërimet dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij” (Alma 7:11).

Ndjenjat e Tërheqjes ndaj së Njëjtës Gjini Nuk Janë Mëkat dhe Ne Mund të Zgjedhim se si të Përgjigjemi

Kisha nuk merr një qëndrim në lidhje me shkakun e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini. Në vitin 2006, Plaku Dallin H. Ouks shpalli:

“Kisha nuk ka një qëndrim mbi shkaqet e ndonjëres prej këtyre ndjeshmërive ose prirjeve, përfshirë ato që lidhen me tërheqjen ndaj së njëjtës gjini” (intervistë në vitin 2006 me Plakun Dallin H. Ouks dhe Plakun Lens B. Uikmen: “Same-Gender Attraction” [“Tërheqja ndaj së Njëjtës Gjini”]).

Ndjenjat e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini nuk janë mëkat. Plaku M. Rasëll Ballard shpalli:

“Le të jemi të qartë: Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme beson se ‘përvoja e tërheqjes ndaj së njëjtës gjini është një realitet i ndërlikuar për shumë njerëz. Tërheqja në vetvete nuk është mëkat, por të vepruarit sipas nxitjeve që ndiejmë është. Edhe pse individët nuk zgjedhin që t’i kenë tërheqje të tilla, ata vërtet zgjedhin se si t’u përgjigjen atyre. Me dashuri dhe mirëkuptim, Kisha u drejtohet të gjithë fëmijëve të Perëndisë, duke përfshirë [ata që kanë tërheqje ndaj së njëjtës gjini]” (“The Lord Needs You Now!” [“Zoti Ka Nevojë për Ty Tani!”] Ensigh, shtator 2015, f. 29).

Edhe pse tërheqja ndaj së njëjtës gjini nuk është mëkat, ajo mund të jetë një sfidë. Edhe pse një njeri mund të mos ketë zgjedhur që t’i ketë këto ndjenja, ai ose jo mund të zotohet që t’i mbajë urdhërimet e Perëndisë. Prindi i një fëmije që përjeton tërheqje ndaj së njëjtës gjini ose identifikohet si gej, duhet të zgjedhë që ta dojë dhe ta përqafojë atë fëmijë. Si një komunitet anëtarësh të Kishës, ne duhet të zgjedhim që të krijojmë një komunitet mikpritës.

“Ai i fton të gjithë të vijnë tek ai dhe të marrin pjesë në mirësinë e tij; dhe ai nuk ia mohon askujt që shkon tek ai, . . . të gjithë janë njësoj para Perëndisë” (2 Nefi 26:33).

Njerëzit që i Jetojnë Ligjet e Perëndisë, Mund të Marrin Pjesë Plotësisht në Kishë

“Në të vërtetë unë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm” (Veprat e Apostujve 10:34).

Perëndia premton se, në qoftë se u bindemi ligjeve të Tij, ne do të kemi gëzim të përjetshëm dhe Ai përherë i mban premtimet e Tij. Qartësisht, njerëzit që përjetojnë tërheqje ndaj së njëjtës gjini ose identifikohen si gej, mund t’i bëjnë premtime Perëndisë dhe t’i mbajnë ato. Ata mund të ecin në dritën e Tij. Ata mund të marrin pjesë plotësisht në Kishë.

“Nëse anëtarët ndiejnë tërheqje ndaj së njëjtës gjini, por nuk përfshihen në ndonjë sjellje homoseksuale, udhëheqësit duhet t’i përkrahin dhe t’i nxitin ata në vendimin e tyre për ta jetuar ligjin e dëlirësisë dhe për t’i kontrolluar mendimet e padrejta. Këta anëtarë mund të marrin thirrje në Kishë. Nëse janë të denjë dhe të kualifikuar në çdo mënyrë tjetër, ata gjithashtu mund të mbajnë rekomandime tempulli dhe të marrin ordianca të tempullit” (*Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]*, 21.4.6).

Presidenti Gordon B. Hinkli shpalli:

“Ne i duam ata si bij dhe bija të Perëndisë. Ata mund të kenë disa prirje që janë të fuqishme dhe që mund të jenë të vështira për t’u kontrolluar. Shumica e njerëzve kanë prirje të një lloji apo një tjetri në periudha të ndryshme. Nëse nuk veprojnë sipas këtyre prirjeve, atëherë ata mund të shkojnë përpara siç bëjnë të gjithë anëtarët e tjerë të Kishës. Nëse i shkelin ligjin e dëlirësisë dhe standardet morale të Kishës, atëherë ata i nënshtrohen disiplinës së Kishës, sikurse i nënshtrohen të tjerët” (“What Are People Asking about Us?” [“Çfarë Duan të Dinë Njerëzit për Ne?”] konferenca e përgjithshme e tetorit 1998).

Cilatdo qofshin rrethanat e një personi, ai ose ajo mund të kontribuojë në kauzën e Zotit tani dhe mund të presë që besnikëria e tij ose e saj do të japë, këtu dhe pas kësaj jete, të njëjtat bekime që premtohen nga Perëndia për këdo që është besnik në mënyrë të ngjashme. Plaku D. Tod Kristoferson ka vërejtur:

“Çdo njeri ka dhurata; çdo njeri ka talente; çdo njeri mund të japë ndihmesë në shpalosjen e planit hyjnor në secilin brez. Shumë prej asaj që është e mirë, shumë prej asaj që është thelbësore – madje nganjëherë gjithçka që është e nevojshme për tani – mund të arrihet edhe në rrethana më pak se ideale. Kaq shumë prej jush po bëni më të mirën që mundeni. Dhe kur ju që mbani barrët më të rënda të vdekshmërisë, ngriheni në mbrojtje të planit të Perëndisë për ekzaltimin e fëmijëve të Tij, ne të gjithë jemi gati për të marshuar. Me vetëbesim ne dëshmojmë se Shlyerja e Jezu Krishtit e ka paraprirë dhe, më së fundi, do ta dëmshpërblejë gjithë mungesën e mundësive dhe humbjen për ata që kthehen tek Ai. Askush nuk është i paracaktuar që të marrë më pak sesa gjithçka që Ati ka për fëmijët e Tij” (“Përse Martesa, Përse Familja”, konferenca e përgjithshme e prillit 2015).

Ligji i Dëlirësisë Gjen Zbatim për të Gjithë Fëmijët e Perëndisë

Pastërtia seksuale është një pjesë thelbësore e planit të Perëndisë për lumturinë tonë. Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve shpallën:

“Urdhërimi i parë që Perëndia i dha Adamit dhe Evës, ishte rreth potencialit të tyre si burrë e grua për të qenë prindër. Ne deklarojmë se urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e Tij që të shumohen dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm. Ne më tej deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte” (“Familja: Një Proklamim drejtuar Botës”).

Marrëdhëniet seksuale midis një burri dhe një gruaje që nuk janë të martuar, ose midis njerëzve të së njëjtës gjini, janë mëkatore dhe shkelin një nga ligjet më të rëndësishme të Atit tonë në Qiell, dhe e pengojnë përparimin tonë të përjetshëm.

“Ligji i Zotit për dëlirësinë është shmangie nga marrëdhëniet seksuale jashtë martesës së ligjshme dhe besnikëri brenda martesës. Marrëdhëniet seksuale janë të përshtatshme vetëm midis një burri dhe një gruaje që janë zyrtarisht dhe ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte. Kurorëshkelja, lavirësia, marrëdhëniet homoseksuale ose lesbike dhe çdo praktikë tjetër jo e shenjtë, e panatyrshme ose e papastër janë mëkatore” (*Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]*, 21.4.5).

Njerëzit me çfarëdo orientimi gjinor që e shkelin ligjin e dëlirësisë, mund të paqësohen me Perëndinë nëpërmjet pendimit.

“Mos shkel kurorën; dhe ai që shkel kurorën dhe nuk pendohet, duhet të dëbohet. Por ai që e ka shkelur kurorën e pendohet me gjithë zemër dhe e braktis atë e nuk e bën më, ai duhet të falet” (Doktrina e Besëlidhje 42:24–25).